

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Franco Foda flet për tërheqjen e Amir Rrahmanit
ADRESA	https://www.koha.net/futboll/franco-foda-flet-per-terheqjen-e-amir-rrahmanit
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 00:46:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 12:28:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6d42d3befec440af5c6996679a382587f3173f0c89a68814fc147faec5013ac4
TEKSTI	e4f7c1e6def7349e9788bd7321d02b9f09a5ecea1b1c2002d685ab6d6c62099d
PAMJA	f6424b78bd14dbd9899d92b3273e2f82ab211866b982fd09be35096cc9a363b9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3e76e8da7835f8c979345f3f1b14c20876087694db6603ad2c63efe3c933d55d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4bcdcd4d243612cb18c5cb2126f4f1c397c4419b3c987ae6534b84438e325555a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/3e76e8da7835f8c979345f3f1b14c20876087694db6603ad2c63efe3c933d55d

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

FUTBOLL

Franco Foda flet për tërheqjen e Amir Rrahmanit



Nga: Faton Polisi

17 shtator 2026 14:28

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Përzgjedhësi i Kosovës në futboll, Franco Foda, e ka komentuar vendimin e Amir Rrahmanit javën e kaluar për t'u tërhequr nga ekipi përfaqësues i Kosovës.

Foda ka thënë se ishte njoftuar personalisht nga Rrahmani për vendimin për t'u tërhequr nga Kosova "përderisa FFK-në e udhëheqin personat aktualë".

"Gjithçka është shumë emocionale në Kosovë. Fakti është se Amir Rrahmani ka dhënë dorëheqjen. Ai më informoi personalisht për këtë. Por të gjithë lojtarët që janë në formë dhe që do t'i ftoj do të jenë atje të hënën dhe do të përgatiten për ndeshjet së bashku me mua", ka thënë Foda në "CANAL+" gjatë ndeshjes së Ligës së Evropës ndërmjet Sturm Grazit dhe Rennesit, shkruan të enjten mediumi i madh austriak, "Laola1".

Foda ka mohuar se rrugën e Rrahmanit do ta ndjekin edhe të tjerët.

"Ka shumë dramë që po ekzagjerohet. Ideja se edhe më shumë lojtarë duan të bojkotojnë ekipin kombëtar nuk është e vërtetë", ka theksuar Foda.

Edhe



Futboll • 13 sht 2026

Taulant Hodaj me akuza të reja për rastin Rrahmani, FFK-ja nuk deklarohe

Rrahmani te Kosova i ka 67 paraqitje e shtatë gola. Shumicën e paraqitjeve i kishte si kapiten. Ai në fakt bëri karrierë ndërkombëtare në nivelin senior edhe te Shqipëria. Në vitin 2016 iu bashkua përfundimisht Kosovës. Dhe ka kontribuar shumë në sukseset që i kishte Kosova.

Rrahmani njoftoi tërheqjen e përkohshme të premtën e kaluar. Para se mbrojtësi 32-vjeçar i Napolit të njoftonte për largimin nga Përfaqësuesja e Kosovës, zyra e avokatëve "Hodaj & Partners" njoftoi se ka marrë përsipër përfaqësimin ligjor të futbollistit, "lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me sulmet, kërcënimet, fyerjet dhe cenimin e reputacionit të tij nga persona kvcë dhe të lidhur brenda FFK-së". Këtë zvrë e dreiton Taulant

Arbëri.

Ukshini: Me vendimin e Hagës rruga e Kosovës në planin ndërkombëtar do të jetë e vështirë

Kulturë.

"Bota e Todhrit..." ringjall përditshmërinë e Elbasanit të shekullit të 18-të

Futboll.

Beshiktashi fiton para tifozëve të vet

Futboll.

Zeneli i pandalshëm asiston sërish

Futboll.

Juventusit fiton thellë në nisje të Ligës së Evropës

Futboll.

17-vjeçari i Cityt shkëlqen në Kupën e Ligës

Hodaj, që për disa vjet mbajti pozitë me rëndësi në FFK.

Sipas një postimi të kësaj zyre, "për më shumë se dy vjet, kapiteni Rrahmani është përballur me kërcënime, sulme dhe presione të vazhdueshme. Përkundër kësaj, ai ka zgjedhur që shqetësimet e tij t'i adresojë brenda dhe të mos i bëjë publike, duke vënë interesin e Kombëtares dhe të Kosovës para interesit të tij personal".

Futbollisti prishtinas ishte shprehur i pakënaqur me drejtuesit aktualë të Federatës së Futbollit të Kosovës dhe për këtë arsye ka vendosur të tërhiqet.

"Pas 10 vjetëve në Kombëtare, nga të cilat shtatë si kapiten, ju njoftoj se nuk do të jem më pjesë e Kombëtares së Kosovës, përderisa FFK-në e udhëheqin personat aktualë", kishte shkruar Rrahmani.

Ai kishte lënë të kuptohet se gjërat që e kanë munduar, e që nuk i ka bërë publike, nuk ka mundur t'i zgjedhë brenda familjes kosovare të futbollit. Ka akuzuar edhe për mungesë kompetence nga përgjegjësit në federatë.

Edhe



Futboll • 11 sht 2026

Largimi i papritur i kapitenit Rrahmani nga ekipi përfaqësues i Kosovës

Nga Federata ende nuk ka pasur ndonjë reagim.

FFK-ja nuk është deklaruar për vendimin e akuzat e Rrahmanit.

#AMIR RRAHMANI

#FRANCO FODA

#KOSOVA

Artikuj të ngjashëm



Futboll • 12 sht 2026

Për tërheqjen e Rrahmanit shkruajnë edhe mediumet ndërkombëtare



Futboll • 11 sht 2026

Rrahmani tërhiqet nga Përfaqësuesja, derisa FFK-ja mban udhëheqjen aktuale



Futboll • 11 sht 2026

Akuza: Sulme e kërcënime ndaj Rrahmanit nga "persona kyç dhe të lidhur brenda FFK-së"

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbejnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.